



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME FIER SH.A

Nr. _____ prot

Fier, më ____/____/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje elektropompa zhytëse e panele”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Panele komantimi 30231200-9

Pompa uji 42122130-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

18,000,000 (tetëmbëdhjetë milion) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Autoriteti/enti Kontraktor “Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Fier” Sh.A, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

2.1.1 Të jetë qartësisht e specifikuar në QKB, se objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik është i njëjtë ose “ekuivalent” me objektin e prokurimit.

➤ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare, **ku vlera mesatare e së cilës, të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës (vlera e fondit limit)**. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori Ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 pika 3 i LPP, si dhe nenin 43 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilanceve për vitet (2021-2022) të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 4 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2023**, pranë njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës. **Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, nëni 3.1/a, b, c dhe nëni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

➤ 2.3 KAPACITETI TEKNIK:

Për kapacitetin teknik operatori ekonomik duhet të paraqesë:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2021-2022-2023) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vlera totale e të cilave duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet**, të realizuar gjatë ketyre tre viteve.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Arsyetimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1/gërma“c” të Ligjit nr.162, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e Cilësisë **ISO 9906:2012 të klasës 3B; më të lartë** ose (*ekuivalente me të*) mbi konformitetin e standardeve europiane të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë si: **SSH EN 809; SSH EN ISO 12100; SSH EN 60034, SSH EN ISO14121; SSH EN ISO 3744.**

Arsyetimi: Kërkesa e mësipërme pika 2.3.2 është vendosur sipas nenit 79, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe në nenin 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është vendosur ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit.Çertifikatat duhet të lëshohen nga organet kompetente për të vërtetuar se mallrat i plotësojnë kërkesat e cilësisë duke mundur realizimin në kohë, dhe me cilësi sipas standardeve të kërkuara.

2.3.3 OE ofertues duhet të paraqesë **Autorizim Prodhuesi** ose **distributor zyrtar** për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të provojë me dokument, lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Arsyetimi: Kërkesa e mësipërme pika 2.3.4 është vendosur sipas nenit 40 pika 3, neni 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe në nenin 36 pika 3/b) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Ky kriter është vendosur ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Katalogun e prodhuesit** të mallrave, ku të vërtetojë përputhjen e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara.

Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen, ku të vërtetohet që mallrat e ofruar, plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara. **Pjesët e katalogut ku tregohen specifikimet teknike, të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.**

Arsyetimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një deklaratë që merr përsipër transportin e mallrave drejt ambjenteve të SHRUK Fier, sipas kërkesave të këtij të fundit.

Argumentim: vendosur në përputhje me VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), neni 40 pika 5/gërma ç.

❖ SPECIFIKIMET TEKNIKE

I-Të përgjithshme

Karakteristikat konstruktive të grupit të pompave të puseve

Pompat elektrike zhytëse- Të përshtatshme për instalim në një pus, rezervuar për akumulimin e ujit ose aplikime të tjera mbështetëse. Pompë dhe motor që përmbushin standartet **shqiptare SSH** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë si: SSH EN 809; SSH EN ISO 12100; SSH EN 60034, SSH EN ISO14121; SSH EN ISO 3744.

Kurba e performancës së pompës të paraqitet sipas ISO9906:2012 klasës 3B ose më të lartë.

Pompat të punojnë pa shfaqura avari edhe në rastet kur ka përmbajtje rëre deri në 100g/m³.

Klasa e mbrojtjes të motorrit të jetë të paktën IP68.

Tipi i izolimit të motorrit të paktën Y.

NPSH e pompave jo më e vogël se 3m.

- *Karakteristikat e materialeve të përdorura për prodhimin e pompave:*

Filtri i thithjes:	Inoks AISI 304
Kafazi i thithjes:	Gizë
Helika:	Inoks AISI 304
Difuzori:	Inoks AISI 304
Bokulla e kushinetës	Gome nitrile
Boshti i pompës	Inoks AISI 304
Trupi i kundralvalvulës	Gizë
Tapa e valvulës	Inoks AISI 304
Mbështetësja e valvulës	Teflon ose <i>ekuivalent</i> me përmbajtje karboni
Fllanxha lidhëse	Çelik
Mbrojtësja e kabllit	Inoks AISI 304
Gominat izoluese	Gomë Nitrile
Vidat dhe pjesët e tjera të pompës	Inoks AISI 304
Motorr elektrik zhytës me fllanxha, 50Hz, a-sinkron, trefazor i lubrifikuar me ujë.	

- *Karakteristikat e materialeve të përdorura për prodhimin e motorrëve*

Rrotori	Inoks
Suportet	Gizë
Trupi i motorrit	Gizë
Gomina e kabllit	Gomë nitrile
Gomina e suportit me trupin	Gomë nitrile
Mbrojtja e pështjellave	Poliacetal
Baza e motorrit	Gizë
Diafragma	Gomë nitrile
Mbulesa e diafragmës	Inoks
Kushineta	Inoks me grafit
Balancuesit	Inoks

- *Karakteristikat e kabllit të pompave:*

Kabli duhet të jetë fleksibël me rezistencë të lartë ndaj tërheqjes, min 15N/mm².
Të jetë i testuar në tension 2000V dhe temperaturë deri në 200°C.

II- Specifike të veçanta

Karakteristikat minimale të veçanta të pompave zhytëse

❖ **Elektropompë 45KW zhytëse +Panel Inverter Q=60l/s H=20m**

Prurjet (Q)	l/s	60
Shtytja (H)	m	20
Fuqia e motorrit (max)	kW	25
Energjia e konsumuar (max)	kW	20
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i flanzhës të dërgimit	mm	152

- *Paneli duhet të jetë i kompletuar me komponentët si në vijim:*

Panel metalik IP55

Inverter 45kW 88A (lëshues me rregullim frekuence)

Rele monitorimi për tensionin dhe nivelin e ujit në pus

Rele mungesë faze

Automat kryesor

Transformator izolues 380/220V për qarkun e komandimit

Llampa sinjali

Butona

Levë e jashtme e derës së panelit për komandimin e automatit kryesor

Aksesorët e ndryshëm, kablo, fije, kapikorda, kanalina, emërtime etj..

- *Paneli duhet të mundësojë:*

Kontrollin e mbtensionit, kontrollin e nëntensionit, monitorimi i rrjedhjes së tokëzimit të motorrit dhe kabllit të motorrit, mbrojtje nga qarku i shkurtër i motorrit dhe kabllit të motorrit. Mbrojtja nga rritja e temperaturave. Supervizimin e ndërrimit të hyrjeve dhe daljeve.

Mbrojtje e motorrit nga mbingarkesa, detektimi i humbjes së fazës (motorri dhe rrjeti), supervizim i rënies së menjëhershme të ngarkesës (këputje e helikës së pompës), supervizim i mbingarkesës, mbrojtje nga rënia e xhirove.

Paneli duhet të jetë konform kërkesave të standardit SSH EN 61800-5-2.

❖ **Elektropompë zhytëse Q=15l/s H=280m**

Prurjet (Q)	l/s	15
Shtytja (H)	m	280
Fuqia e motorrit (min)	kW	75
Energjia e konsumuar (max)	kW	66
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	mm	168

❖ **Elektropompë zhytëse Q=40l/s H=150m**

Prurjet (Q)	l/s	40
Shtytja (H)	m	150
Fuqia e motorrit (min)	kW	92
Energjia e konsumuar (max)	kW	86
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	mm	168

❖ **Elektropompë zhytëse Q=9l/s H=200m**

Prurjet (Q)	l/s	9
Shtytja (H)	m	200
Fuqia e motorrit (min)	kW	26
Energjia e konsumuar (max)	kW	24
Xhirot e motorrit	Rpm	2850
Diametri i dërgimit	inch	3

❖ **Elektropompë zhytëse Q=7l/s H=220m**

Prurjet (Q)	l/s	7
Shtytja (H)	m	220
Fuqia e motorrit (min)	kW	30
Energjia e konsumuar (max)	kW	25
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	inch	3

❖ **Elektropompë zhytëse Q=7.5l/s H=200m**

Prurjet (Q)	l/s	7.5
Shtytja (H)	m	200
Fuqia e motorrit (min)	kW	26
Energjia e konsumuar (max)	kW	25
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	inch	3

❖ **Elektropompë zhytëse Q=6l/s H=115m**

Prurjet (Q)	l/s	6
Shtytja (H)	m	115
Fuqia e motorrit (min)	kW	12
Energjia e konsumuar (max)	kW	16
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	inch	3

❖ **Elektropompë zhytëse Q=7l/s H=150m**

Prurjet (Q)	l/s	7
Shtytja (H)	m	150
Fuqia e motorrit (min)	kW	19
Energjia e konsumuar (max)	kW	19

Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	inch	3

❖ **Elektropompë zhytëse Q=3l/s H=50m**

Prurjet (Q)	l/s	3
Shtytja (H)	m	50
Fuqia e motorrit (min)	kW	3
Energjia e konsumuar (max)	kW	2.9
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	inch	2

❖ **Elektropompë zhytëse Q=26.3l/s H=231m**

Prurjet (Q)	l/s	26.3
Shtytja (H)	m	231
Fuqia e motorrit (min)	kW	90
Energjia e konsumuar (max)	kW	82
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	inch	5

❖ **Elektropompë zhytëse Q=12l/s H=90m**

Prurjet (Q)	l/s	12
Shtytja (H)	m	90
Fuqia e motorrit (min)	kW	15
Energjia e konsumuar (max)	kW	14.5
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	inch	3

❖ **Elektropompë zhytëse Q=5.5l/s H=200m**

Prurjet (Q)	l/s	5.5
Shtytja (H)	m	200
Fuqia e motorrit (min)	kW	20

Energjia e konsumuar (max)	kW	19
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	inch	3

❖ **Elektropompë zhytëse Q=4l/s H=60m**

Prurjet (Q)	l/s	4
Shtytja (H)	m	60
Fuqia e motorrit (min)	kW	4
Energjia e konsumuar (max)	kW	4
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	inch	2 1/2

❖ **Elektropompë zhytëse Q=8l/s H=152m**

Prurjet (Q)	l/s	8
Shtytja (H)	m	152
Fuqia e motorrit (min)	kW	22
Energjia e konsumuar (max)	kW	22.5
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	inch	3

❖ **Elektropompë zhytëse Q=8l/s H=50m**

Prurjet (Q)	l/s	8
Shtytja (H)	m	50
Fuqia e motorrit (min)	kW	7.5
Energjia e konsumuar (max)	kW	7.5
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	inch	3

❖ **Elektropompë zhytëse Q=7l/s H=100m**

Prurjet (Q)	l/s	7
Shtytja (H)	m	100

Fuqia e motorrit (min)	kW	13
Energjia e konsumuar (max)	kW	12
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	inch	3

❖ **Elektropompë zhytëse Q=3l/s H=60m**

Prurjet (Q)	l/s	3
Shtytja (H)	m	60
Fuqia e motorrit (min)	kW	3
Energjia e konsumuar (max)	kW	3
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Përmasat totale (max) D x L	mm	145x1350

❖ **Pompa për puse me kundravalvul të integruar**

Kurba e performances së pompës të paraqitet sipas ISO9906:2012 klasës 3B ose më të lartë.

Pompat të punojnë pa shfaqur avari edhe në rastet kur ka përmbajtje rëre deri në 300g/m³.

Klasa e mbrojtjes të motorrit të jetë të paktën IP68.

Tipi i izolimit të motorrit të paktën F

Pompa të jetë material Inoks AISI 304

Helika të jetë material polimer.

Boshti i pompës material Inoks AISI 420

Fllanxhat Inoks AISI304

Kafazi thithës Gize

❖ **Elektropompë zhytëse Q=2.5-3l/s H=80m**

Prurjet (Q)	l/s	3
Shtytja (H)	m	80
Fuqia e motorrit (min)	kW	3
Energjia e konsumuar (max)	kW	6
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	inch	2

❖ **Elektropompë zhytëse Q=3l/s H=120m**

Prurjet (Q)	l/s	3
Shtytja (H)	m	120
Fuqia e motorrit (min)	kW	7.5
Energjia e konsumuar (max)	kW	8
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	inch	2

❖ **Pompë Zhytëse grirëse për KUZ 3KW**

Elektropompë zhytëse me helike dhe sistem grirës për të mundësuar thithjen dhe dërgimin e ujërave të ndotura. Pompa të jetë e përshtatshme për tu futur në thellësi të paktën 20 metër.

Trupi i pompës Gizë

Helika Gizë

Grirësi Inoks

Klasi i izolimit F

Prurjet (Q)	l/s	25
Shtytja (H)	m	28.5
Fuqia e motorrit (min)	kW	3
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	mm	65

➤ **Karakteristika të përgjithshme të pompave centrifugale vertikale 25 bar**

Pompë vertikale me shumë shkallë me performancë të lartë, permistopi i pompës të jetë i ndërrueshëm lehtë për mirëmbajtje sa më të thjeshtë. Kurba e performancës së pompës vizatohet sipas standardit ISO9906:2012 klasës 3B ose më të lartë.

Presioni i punës	PN16 – PN64
Përputhshmëria VSD	PO
Temperatura e lëngut	-15°C to +85°C

❖ **Elektropompë vertikale Q=8l/s H=40m**

Prurjet (Q)	l/s	8
Shtytja (H)	m	40
Fuqia e motorrit (min)	kW	5
Energjia e konsumuar (max)	kW	6.2
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	mm	65

❖ **Elektropompë vertikale Q=5l/s H=70m**

Prurjet (Q)	l/s	5
Shtytja (H)	m	70
Fuqia e motorrit (min)	kW	5.5
Energjia e konsumuar (max)	kW	6
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	mm	50

❖ **Elektropompë sipërfaqësore Q=6l/s H=100m n=18Kw**

Prurjet (Q)	l/s	6
Shtytja (H)	m	100
Fuqia e motorrit (min)	kW	11
Energjia e konsumuar (max)	kW	10
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	mm	50

❖ **Elektropompë sipërfaqësore Q=7l/s H=200m**

Prurjet (Q)	l/s	7
Shtytja (H)	m	200
Fuqia e motorrit (min)	kW	30

Energjia e konsumuar (max)	kW	28
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	mm	65

❖ Elektropompë sipërfaqësore Q=3l/s H=100m

Prurjet (Q)	l/s	3
Shtytja (H)	m	100
Fuqia e motorrit (min)	kW	7.5
Energjia e konsumuar (max)	kW	7
Xhirot e motorrit	Rpm	2900
Diametri i dërgimit	mm	50

➤ Karakteristika të përgjithshme të pompave centrifugale vertikale

Pompë vertikale me shumë shkallë me performancë të lartë, Boshti i pompës i mbështetur në kushineta të dyfishta për rezistencë të lartë dhe për të ofruar mundësi instalimi vertikalisht dhe horizontalisht. Kurba e performancës së pompës vizatohet sipas standardit ISO9906:2012 klasës 3B ose më të lartë.

Portat (thithje – shkarkim)	PN16 – PN64
Temperatura e lëngut	-15°C to +90°C

- Helikat duhet të jenë të dizajnuara me rrjedhje radiale, konstrukcion të fortë, të balancuar dinamikisht me sistem balancues të ngarkesës në kasën e daljes, secila helikë do të ketë një unazë konsumimi inoksi të zëvendësueshme e cila do të fiksohet me boshtin e pompës.
- Pompa do të përfshijnë lopata(helika) shpërndarëse me unaza konsumimi të zëvendësueshme, do të sigurojnë mbështetje në bosht, çdo shkallë e pompës do të pajiset me tap kullimi.
- Çdo shpërndarës do të jete e pajisur me unaza të zëvendësueshme. Lidhjet e pompës si në thithje dhe shkarkim do të bëhen me 4 prixhonier për secilën.
- Boshti i pompës është i shtrirë në mënyrë perfekte, i balancuar dinamikisht, i mbrojtur plotësisht dhe ka unaza konsumimi të zëvendësueshme në pikat mbështetëse.
- Mbështetja e boshtit është e dyfishtë, dy kushineta me drejtim të dyfishtë të lubrifikuar me graso, me përmasa të mëdha, që marrin ngarkesa radiale dhe aksiale në skajet e boshtit. Suporti i kushinetave me fortësi të lartë strukturore përmban graso rezistente dhe/ose sondë të temperaturës së kushinetave.
- Izolimi i boshtit arrihet me përdorimin e permistopave mekanik në përputhje me standartin SSH EN12756 dhe me anë të pjesëve të çelikut special të cilat janë të ndërrueshme për mirëmbajtje sa më të lehtë. Permistopat të jenë me material antimoni me karbon të integruar, pjesët metalike përbërëse të tij të jenë inoksi i gradës 316 ose më të lartë.
- Pozicioni i ndryshueshëm i portës së hyrjes dhe daljes me 90°

Materiali:

Helika	Gize EN-GJL250 ose standart më i lartë
Difuzori	Gize EN-GJL250 ose standart më i lartë
Kasa e shtytësit	Gizë EN-GJS-450-10 ose standart më i lartë
Kasa e shkarkimit	Gizë EN-GJS-450-10 ose standart më i lartë
Kasa e thithjes	Gizë EN-GJS-450-10 ose standart më i lartë
Mbështetja e kushinetës	Gizë EN-GJL250 ose standart më i lartë
Unazat e konsumit	CuSn10-C ose standart më i lartë
Boshti	Inoks1.4028 ose standart më i lartë
Suporti i boshtit	Inoks1.4028 ose standart më i lartë
Pistoni balancues	Inoks1.4028 ose standart më i lartë

❖ SASIA dhe GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Elektropompë zhytëse 45 Kw + Panel Inverter Q=60 l/s H=20m	copë	1
2	Elektropompë zhytëse Q=7 l/s H=220m	copë	1
3	Elektropompë zhytëse Q=15 l/s H=280m	copë	1
4	Elektropompë zhytëse Q= 40 l/s H= 150m	copë	1
5	Elektropompë zhytëse Q= 7.5 l/s H= 200m	copë	1
6	Elektropompë zhytëse Q= 7 l/s H= 150m	copë	1
7	Elektropompë zhytëse Q= 3 l/s H= 120m	copë	1
8	Elektropompë zhytëse Q= 3 l/s H= 50m	copë	1
9	Elektropompë sipërfaqësore Q=7 l/s H=200m	copë	1
10	Elektropompë sipërfaqësore Q=6 l/s H=100m n=18KW	copë	1
11	Elektropompë sipërfaqësore Q=3 l/s H=100m	copë	1
12	Elektropompë zhytëse Q=12 l/s H= 90m	copë	1

13	Elektropompë zhytëse Q=4 l/s H= 60m	copë	1
14	Elektropompë zhytëse Q=8 l/s H= 152m	copë	1
15	Elektropompë zhytëse Q=6 l/s H= 115m	copë	1
16	Elektropompë zhytëse Q=8 l/s H= 50m	copë	1
17	Elektropompë zhytëse Q=7 l/s H= 100m	copë	1
18	Elektropompë zhytëse Q=3 l/s H= 60m	copë	1
19	Pompë Zhytëse grirëse për KUZ 3KW	copë	1
20	Elektropompë vertikale Q=5 l/s H=70m	copë	1
21	Elektropompë vertikale Q=8 l/s H=40m	copë	1
22	Elektropompë zhytëse Q=2.5-3 l/s H= 80m	copë	1
23	Elektropompë zhytëse Q=26.3 l/s H= 231m	copë	1
24	Elektropompë zhytëse Q=5.5 l/s H= 200m	copë	1
25	Elektropompë zhytëse Q=9 l/s H= 200m	copë	1

❖ Grafiku i Lëvrimit

Lëvrimi i mallit të bëhet sipas nevojave të AK, partia e I (nr.rendor 1-10) brenda muajit të parë, zërat me nr.rendor 10-20 brenda muajit të dytë, zërat me (nr.rendor 20-25) brenda muajit të tretë. Afatet e lëvrimit: nga momenti i nënshkrimit të Kontratës deri në 12 muaj.

Shënim: këto afate mund të ndryshojnë në varësi të situatave, emergjencave dhe nevojave të punës.

NJËSIA E PROKURIMIT

1. _____ 2. _____ 3. _____